

Mbështetja në gjuhën amtare,mësimdhënia dhe ndihma orientuese

- Gjuha amtare ka një domethënie të madhe për krijimin e identitetit dhe vetëbesimit të fëmijët
- Gjuha amtare është themeli mbi të cilin ndërtohet aftësia e tij për të mësuar
- Fëmija e ka më të lehtë të mësojë gjuhën e dytë e lëndët e tjera
- Njerëz që dijnë shumë gjuhë janë pasuri (përparësi) e shoqërisë

Çfarë është mbështetja në gjuhën amtare?

Sipas planit mësimor të ciklit parashkollor duhet t' i jipet mundësia fëmijëve ,të cilët nuk kanë gjuhë amtare gjuhën suedeze të zhvillojnë njohuritë e tyre edhe në gjuhën amtare.Një mësues i gjuhës amtare i takon fëmijët një herë në javë.Ai ose ajo vjen nga i njëjti vend nga i cili vijnë edhe fëmijët.Ata luajnë,këndojnë,vizatojnë,presin e ngjeshin dhe lexojnë përralla në gjuhën amtare të fëmijëve.Mësuesi i gjuhës amtare munt t' i drejtojë fëmijët në lojë e këngë dhe në këtë mënyrë t' u shpjegojë atyre kulturën dhe t' ua forcojë besimin në identitetin kombëtar.Disa studime tregojnë se mundësia e ushtrimit të gjuhës amtare që në ciklin parashkollor ,ata fëmijë do të kenë rezultate më të mira në shkollë.Krijohet një urë ndërmjet gjuhës së përdorur në parashkollor dhe gjuhës së përdorur në shtëpi(familje).

Në Tranemo kemi këto gjuhë:gjuha shqipe,arabisht,boshnjakisht,serbisht,kroatisht,gjuhën rome,somalisht,gjuhën tailandeze,gjuhën e shenjave (gjesteve),dhe rusisht.

Çfarë është mësimdhënia në gjuhën amtare

Mësimi i gjuhës amtare është një lëndë e veçantë ,e cila zhvillohet në shkollën fillore dhe atë të mesme.Qëllimi është që fëmijët të përfitojnë sa më shumë nga mësimi në shkollë dhe në të njëjtën kohë të zhvillojnë kompetencën dhe identitetin e tyre dy gjuhësor.Puna do të zhvillohet në mënyrë të tillë që zhvillimi personal i fëmijëve të favorizohet dhe besimi në identitetin e tyre të forcohet.Mësimdhënësit e gjuhës amtare janë zakonisht nga i njëjti vend nga i cili janë edhe fëmijët.Mësuesit e gjuhës amtare duhet poashtu që të kenë njohuri të mira mbi gjuhën dhe shoqërinë suedeze.Mësimi i gjuhës amtare është me dëshirë (vullnetar) dhe prindërit duhet që të kërkojnë këtë.Të gjithë nxënësit të cilët në shtëpi flasin një gjuhë tjetër veq suedishtes mund të ndjekin mësimet në gjuhën amtare.Për gjuhët e minoriteteve (pakicave gjuhësore) ,mësimin në gjuhën amtare mund t' a

ndjekin fëmijët edhe nëse nuk e flasin gjuhën rregullisht në shtëpi. Edhe fëmijët e adoptuar, të cilët për shkaqe të kuptueshme nuk e flasin gjuhën amtare, kanë të drejtë në mbështetjen si dhe mësimin në gjuhën amtare. Në komunën e Tranemos ekzistojnë përafërsisht 200 nxënës që kanë ndonjë gjuhë tjetër amtare, prej tyre përafërsisht 125 nxënës mësojnë gjuhën e tyre amtare. Gjatë vitit shkollor 2010/2011 mësimi i gjuhës amtare u organizua në këto gjuhë: shqip, arabisht, boshnjakisht, serbisht, kroatisht, romani (gjuha e romëve), somajlisht, tailandisht, gjermanisht, polonisht (gjuha polake), finlandisht dhe rusisht. Duhet të ekzistojnë sëpaku pesë nxënës që dëshirojnë të mësojnë të njëjtën gjuhë si dhe një mësues i përshtatshëm (volitshëm) që Tranemo-ja t'ia ofrojë mësimin e kësaj gjuhe. Në gjuhët e minoriteteve : samiska, meän kieli , romani e finlandisht mjafton që një fëmijë të kërkojë të mësojë gjuhën e tij amtare.

Çfarë është ndihma orientuese në gjuhën amtare

Fëmijët dhe të rinjtë, të cilët sapo kanë ardhur në Suedi dhe njohuritë e të cilëve nuk mjaftojnë për të ndjekur mësimet në gjuhën suedeze, gëzojnë të drejtën e shpjegimit të mësimin në gjuhën amtare. Prindërit dhe shkolla bashkëbisedojnë mbi nevojën e nxënësit për ndihmën orientuese. Si instancë e fundit, është rektori i shkollës ai që vendos nëse një nxënës ka nevojë për ndihmë orientuese në gjuhën amtare.

Organizimi

Mësimdhënja e gjuhëve mund të organizohet në mënyra të ndryshme në shkollë

- Mësimi i gjuhës amtare si gjuhë e zgjedhur
- Gjuhë amtare, lëndë e veçantë
- Gjuhë amtare si si zgjedhje e lirë e nxënësit ose e shkollës
- Mësimi i gjuhës amtare jashtë orarit shkollor

Këtu mund t'i gjejsh formularët e aplikimit (kërkesën):

Anmälningblanketten för modersmålsstöd (formulari i aplikimit për mbështetjen në gjuhën amtare)

Anmälningblanketten för modersmålsundervisning (formulari i aplikimit për mësimin e gjuhës amtare)

Avslutar modersmålsundervisningen (mbarimi –ndërprerja e mësimin të gjuhës amtare)